



**KUVENDI
KOMISIONI PËR POLITIKËN E JASHTME**

Dokument parlamentar

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

**PËR
PROJEKTLIGJIN**

**“PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (KËSHILLI
I MINISTRAVE) DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA
TË AMERIKËS, PËR PROGRAMIN E SHKËMBIMIT AKADEMIK
“FULBRIGHT”**

➤ **HYRJE**

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës, Komisioni për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e komisionit prezantuan projektligjin Z. Kostandin Shkurti, Zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Z. Erzen Tola, Drejtor i Përgjithshëm Rregullator dhe i Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë.

➤ **BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

➤ QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji ka si qëllim ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për programin e shkëmbimit akademik “Fulbright”.

Memorandumi i mirëkuptimit mundëson bashkëpunimin e Republikës së Shqipërisë me Shtetet e Bashkuara për të vendosur prioritetet e përbashkëta dhe për të formësuar programin për të përmbushur nevojat e përbashkëta, duke synuar kështu zgjerimin dhe rritjen e programit të shkëmbimit akademik dhe kulturor ndërmjet dy vendeve.

Programi i shkëmbimit akademik “Fulbright” për studiues të huaj është një program që u jep mundësi studiuesve të rinj apo me më shumë përvojë, lektorëve të universitetit dhe ekspertëve nga institucione akademike dhe kërkimi të bëjnë kërkime dhe/ose të japin mësim në një universitet në Shtetet e Bashkuara. Programi mbështet shkëmbimet arsimore që forcojnë mirëkuptimin dhe komunikimin mes Shteteve të Bashkuara dhe mbi 155 vendeve në mbarë botën si dhe është një formë efektive e prestigjioze e diplomacisë publike. Në bazë të një procesi të hapur konkurrimi, bursat u jepen kandidatëve që shfaqin më së miri përkushtim në detyrë, si në sektorin publik dhe atë privat, si dhe potencial për të sjellë një qasje pozitive në të ardhmen e Shqipërisë. Bursat zakonisht zgjasin tre deri në gjashtë muaj në një universitet në Shtetet e Bashkuara. Kandidatët janë të detyruar të kthehen në Shqipëri për të paktën 2 (dy) vjet në përfundim të programit.

Ratifikimi i këtij memorandumit mirëkuptimi do të realizojë mbështetjen financiare nga ana e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për sa i takon programit të shkëmbimit akademik “Fulbright Student” duke krijuar kështu mundësi të tjera shitesë për studentët që do të bëhen pjesë e këtij programi.

Shumë prej granteve të huaja “Fulbright” janë për profesionistë të rinj në karrierë, të cilët do të kthehen më pas për të kontribuar në vendet e tyre, shpesh duke punuar në universitete ose në administratën publike.

Pala e Shteteve të Bashkuara të Amerikës do të koordinojë menaxhimin e programit “Fulbright” në Republikën e Shqipërisë, organizimin e përzgjedhjes fillestare të kandidatëve si dhe zhvillimin e aktiviteteve mësimore-shkencore dhe analizimin e potencialit për shkëmbime akademike shitesë.

Pala shqiptare do të ketë përfaqësues në komisionin përzgjedhës pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë për të përzgjedhur studentët, personelin akademik dhe profesionistët që do të marrin pjesë në programin “Fulbright”.

➤ EFEKTET FINANCIARE

Pala shqiptare do të ofrojë mbështetje financiare në shumën prej 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) euro në vit, nëpërmjet fondit të bursave të ekselencës, për të mbështetur kostot e programit “Fulbright Student” me qëllim krijimin e më shumë mundësive për studentët, personelin akademik dhe profesionistët që marrin pjesë në këtë program.

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

➤ DISKUTIME NË KOMISION

Në mbledhjen e komisionit nisma ligjore u prezantua nga përfaqësuesit e Ministrisë për Arsimin, Sportet dhe Rininë, duke theksuar rëndësinë e këtij memorandumi në trajnimin e kapaciteteve akademike të Republikës së Shqipërisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Deputetët u interesuan lidhur me mundësinë e shkëmbimit të profesionistëve amerikanë dhe atyre shqiptarë, duke krijuar kështu mundësinë për shkëmbimin jo vetëm të njohurive akademike, por edhe të kulturave dhe eksperiencave perëndimore.

Deputetët vlerësuan faktin që këta profesionistë të rinj, nëpërmjet këtij memorandumi mbartin detyrimin për t'u rikthyer dhe për të sjellë rezultate në shtetin shqiptar pas kryerjes së studimeve ose trajnimit. Ata shprehën konsideratë dhe vlerësim maksimal për programin "Fullbright", dhe mbështetën propozimin e qeverisë për ratifikimin e memorandumit.

➤ PËRFUNDIME

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim Komisioni për Politikën e Jashtme votoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe me të gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

KRYETARE

Mimi KODHELI